

20.11.2020

Ora 12:00

RENDI I DITËS

Projektakti “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, A.Tenolli**
- **Parti Politike PD, PS, LSI, PDIU**
- **Vëzhgues: KRIK**

Znj.I.Nano: Mirëdita, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator. Janë të pranishëm pesë anëtarët e Komisionit Rregullator kështu që mbledhjen mund ta deklarojmë të hapur. Gjithashtu në mbledhje është i pranishëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, zoti Celibashi dhe përfaqësues të administratës së KQZ-së. Të pranishëm në mbledhje janë përfaqësues të partive politike parlamentare dhe me sa shoh dhe zëvendësues të tyre. Të pranishëm si gjithmonë kemi median. Ndërkohë do të më lejoni të vija në dukje faktin që së fundmi janë miratuar disa

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

kufizime të tjera në kuadër të përballimit të situatës së pandemisë. Kështu që do të ftoja për aq sa është e mundur të respektonim këto kufizime, gjithmonë për aq sa është e mundur. Minimalisht do të kërkoja mirkuptimin e medias që kamerat të jenë statike dhe ndoshta kameramanët të mos jenë. Nuk e di nëse dhe përfaqësuesit e partive të jenë vetëm ata, pa zëvendësuesit në mënyrë që të kufizojmë numrin e personave që ndodhen njëkohësisht në sallë. Ende pa e filluar mbledhjen po bëjmë pesë minuta pushim për të riparë këtë që sapo sugjerova, faleminderit! (bëhen 5 minuta pushim)

Rifillon mbledhja.

Është mbledhja e parë që po bëjmë pas kufizimeve që janë vendosur. Duke nisur nga mbledhja e ardhshme ndoshta do të vlerësojmë mundësitë teknike për ta zhvilluar ndryshe mbledhjen. Ku të jetë mundësia sigurisht përfaqësuesit e partive politike, administrata e KQZ-së, media të kenë akses në mbledhjet publike. Mbledhja e sotme ka vetëm një pikë të rendit të ditës. Kemi një akt të paraqitur nga administrata e KQZ-së dhe që do të prezantohet në mënyrë të përmbledhur relacioni nga ana e Komisionerit. Është një projektregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”. Sigurisht që ky projektakt vjen në kuadër të përmbushjes së një detyrimi dhe kompetence të parashikuar në nenin 20 të Kodit Zgjedhor, si një kompetencë e Komisionit Rregullator. Mendojmë që është një ndër projektaktet më të rëndësishme në funksion të administrimit dhe organizimit të zgjedhjeve rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”. Do të ftoja Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për të paraqitur në mënyrë të përmbledhur projektaktin dhe relacionin përkatës dhe më tej të çelim diskutimet, zoti Celibashi!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Z.I.Celibashi: Faleminderit zonja Kryetare, sikurse dhe ju e thatë, ky projektakt përfshihet në setin e akteve me një rëndësi të shtuar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Është një akt i cili vjen në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor në lidhje me organizimin dhe funksionimin e KZAZ-ve. Në vlerësimin tonë ky akt ka përmbushur të gjitha ato detyrime të cilat i takojnë KQZ-së në raport me mënyrën se si këto komisione do të administrojnë procesin zgjedhor. Janë të përcaktuara dispozitat që kanë të bëjnë me organizimin, funksionimin e këtyre komisioneve, kompetencat e tyre, mënyrat e zhvillimit të veprimtarisë së këtyre komisioneve në përditshmërinë e tyre nga momenti që ato konstituohen deri në shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve. Jemi përpjekur edhe në vazhdim të historikut dhe traditës së krijuar deri më tani, qoftë në miratimin e aktit, por dhe të ndërveprimit të këtyre komisioneve që të sanksionojmë në mënyrë sa më të qartë të gjitha ato aspekte të administrimit të procesit zgjedhor të cilat janë në përgjegjësinë e këtyre komisioneve. Jemi përpjekur që akti të ketë thjeshtësinë e tij për sa është e mundur që ky akt ta ketë në kuptim të asaj se si këta anëtarë do t'i ushtrojnë këto kompetenca në përditshmërinë e tyre. Duke shpresuar që do të gjejnë pikërisht këtë kuptueshmëri nga këta anëtarë. Ndoshta mund të jetë pak voluminoz si akt, por këto janë përgjegjësitë e kompetencat që ligji i ka ngarkuar këtyre komisioneve. Nuk dua të zgjatem më shumë pasi pak a shumë çfarë do të doja të thoja e prezantoja i thashë në lidhje me qëllimin e këtij akti dhe përmbajtjen e tij, fjalën po ua le juve, faleminderit!

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Celibashi, çelim diskutimin në parim të projektaktit “Për miratimin e projektregullores “Për organizimin dhe funksionimin e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, më parë u drejtohem kolegëve anëtarë të Komisionit Rregullator nëse ka një pyetje, diskutim, po zoti Çakaj!

Z.M.Çakaj: Po e nderuar, atëhere lidhur me projektaktin, projektregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”. Nga ana e Komisionerit mbrëmjen e djeshme, ose ditën e sotme, kanë ardhur disa komente dhe sugjerime nga Instituti i Studimeve Politike, lidhur... besoj i është bërë me dije të gjithë partive politike si dhe personave të tjerë të interesuar. Unë personalisht bashkë me kolegen Vukaj, i shqyrtuam këto komente, vërejtje dhe sugjerime. Mendojmë që së pari ato kanë të bëjnë me dispozita të Kodit Zgjedhor. Duke qenë se ky akt është një akt normativ i dalë në zbatim të Kodit Zgjedhor, mendoj se ato sigurisht që mund të vlejné, por vlejné eventualisht në një situatë të ndryshimit të Kodit Zgjedhor. Pra, përcaktimet që qartazi ligjvënësi ka përcaktuar në Kodin Zgjedhor të miratuar në 2008 dhe që ka pësuar ndryshime në vitin 2012, 2015 dhe ndryshimet e fundit më 25 Korrik 2020, në një situatë eventuale që Kodi Zgjedhor mund të ndryshojë, sigurisht që këto mund të reflektohen. Së pari kjo dhe së dyti, e vetmja gjë që mund të jap një përgjigje është shterruese e ka zgjidhur lidhur me të drejtën e propozimit të anëtarëve të KZAZ-ve. Në mënyrë shterruese kjo e drejtë propozimi u është lënë partive politike që dalin nga zgjedhjet parlamentare pararendëse dhe është shterruese në nenin 29 të Kodit Zgjedhor. Po kështu duke qenë se situata politike pas vitit 2017 se si ka precipituar është e zgjidhur besoj në nenin 183 që është një dispozitë tranzitore e Kodit Zgjedhor, pika 8 ku parashikohet që “në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimi shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

tij menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Kjo do të thotë që në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 si dhe në zgjedhjet e para vendore pas zgjedhjeve të përgjithshme, të drejtën e propozimit e kanë partitë politike parlamentare të dala sipas konfigurimit në seancën e parë. Duke falenderuar paraprakisht për komentet, vërejtjet, sugjerimet besoj se do të evidentohen, do të adresohen në momentin e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor.

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Çakaj, në fakt risjellja në vëmendje pikërisht e këtyre dispozitave lidhur me atë ç'ka do të quajmë ne.., në fakt e ka quajtur kodi, përfaqësues të partive parlamentare, ne për më tepër e kemi aplikuar dhe zbatuar që me praninë e përfaqësuesve në të gjitha mbledhjet tona, të partive parlamentare të dala nga zgjedhjet e vitit 2017. Në fakt do t'u drejtohesha përfaqësuesve të partive parlamentare të pranishëm sot në mbledhje nëse kanë ndonjë diskutim në parim për projektaktin. Me sa shoh nuk ka ndonjë diskutim në parim, unë do t'i ftoja kolegët ta votojmë në parim projektregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor".

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet në parim projektakti. Fillojmë diskutimin nen për nen. Sikundër e kemi bërë praktikë, veçanërisht në aktet voluminoze, për shkak se anëtarët e Rregullatorit, përfaqësuesit e partive politike dhe media janë njohur me projektaktin, nuk po e lexoj tekstin një nga një të neneve, por fillojmë me **nenin 1**. Së pari u drejtohem përfaqësuesve të subjekteve të partive politike parlamentare. Sipas rregullores tonë e kanë ata rradhën të parët. Pyetje, diskutime, propozim konkret? Jo! Kolegët? E votojmë nenin 1 Qëllimi dhe objekti i rregullores?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 2. Ligji dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e KZAZ-së.

Të nderuar përfaqësuesit e partive politike pyetje, diskutime? Të nderuar kolegë?

Kalojmë në votim të nenit 2!

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Kalojmë në KREU II PËRBËRJA DHE NGRITJA E KZAZ-së

Neni 3 Përbërja e KZAZ-së

Para se t'u drejtohem përfaqësuesve të partive politike parlamentare, kam unë, ndoshta është një gabim i vogël, por gjithësesi do ta saktësojmë. Në pikën 2 paragrafi 2 i këtij neni "Partitë politike që kanë të drejtën të propozojnë anëtarët e KZAZ-së sipas parashikimeve të paragrafit 1 duhet të jetë, jo 2. Ndonjë propozim konkret? Kolegët? Po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Atëherë, më shumë është për riformulim, duke parë dhe përmbajtjen e këtij neni. Fillohet me përbërjen e KZAZ-së dhe është në mënyrë shterruese dhe mënyra se si propozohen anëtarët dhe pika 11 që është "KZAZ-ja drejtohet dhe mbikëqyret nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve drejtpërdrejt ose nëpërmjet administratës së KQZ-së". Unë do të kisha një propozim në mënyrë që të bënim një ndërthurje të rolit të Komisionerit dhe njëkohësisht dhe përbërjes së KZAZ-së dhe kam propozimin që pika 1 e nenit 3 të kishte këtë përmbajtje "KZAZ-ja

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari.” Pika 2 e këtij neni të ishte “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e KZAZ-së drejtpërdrejtë ose nëpërmjet administratës së KQZ-së përgjatë zgjedhjeve dhe referendumeve”. Pika 3 të bëhej... të kalonte në procedurën e emërimeve të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së duke vazhduar me germën “a”, “b” dhe kjo gjë pastaj të reflektonte kudo në përmbajtje jo vetëm të këtij neni, por dhe të neneve të tjera, ndryshimi i kësaj pike, faleminderit.

Znj.I.Nano: Nëse e kuptova propozimin tuaj “KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari”. Pika 2 “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e KZAZ-së drejtpërdrejtë ose nëpërmjet administratës së KQZ-së veprimtarinë e KZAZ-së..” dhe pika 3 të vendosim “Procedura për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit është si më poshtë”. Për këtë nen kemi propozim tjetër nga kolegët? Votojmë propozimin e zotit Çaka, ku përfshihet çdo gjë që është vetëm ndryshon renditja.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet propozimi i zotit Çaka për riorganizimin e nenit 3, pika 11 kalon në pikën 2 të këtij neni!

Neni 4. Shorti për caktimin e partisë politike që propozon anëtarin e shtatë të KZAZ-së. Në parashikimin e këtij neni janë pasë parasysh praktikat e deritanishme.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator?

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 5. Shorti për renditjen e partive që kanë të njëjtin numër mandatesh dhe votash të fituara në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin. Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 6. Paraqitja e propozimeve për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator?

Votojmë variantin e ardhur nga administrata, nenin 6

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 6!

Neni 7. Veprimet procedurale për emërimin e të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? E votojmë nenin 7.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Miratohet!

Pika 8. Ngritja e KZAZ-ve dhe thirrja e mbledhjes së parë të tyre.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? E votojmë nenin 8.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 8!

Pika 9. Emërimi i kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 9.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 9!

Kalojmë tek neni 10 Shkarkimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së.

Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Më lejoni zonja Nano, në këtë nen do të ndalem tek paragrafi 5 i tij, ku për hir të rritjes së përgjegjshmërisë për respektimin maksimal të funksioneve të anëtarëve të KZAZ-ve dhe sekretarëve të cilët emërohen si të tillë dhe për garantimin më shumë të procesit zgjedhor dhe votës së lirë propozoj që pas shprehjes “..nuk mund të emërohet..” të shtonim lidhëzën sipërore “më” pra “..nuk mund të emërohet më në përbërje të KZAZ-së”. Mendoj që kjo do t'i jepte garanci më shumë procesit dhe pozicioneve të gjithësecilit. Pra norma, ose paragrafi, apo pika mund të jetë “Anëtari apo sekretari i KZAZ-së i shkarkuar nga detyra me

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

vendim të Komisionerit, nuk mund të emërohet më në përbërje të KZAZ-së, kur KAS-i në përfundim të shqyrtimit administrativ ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit”. Pra, ky të jetë një vullnet administrativ për të paralajmëruar që me votën e lirë, apo me procesin nuk mund të luhet, faleminderit.

Znj.I.Nano: Faleminderit zonja Vukaj. Propozime të tjera për ndryshime, apo shtesa në këtë nen? Votojmë propozimin e zonjës Vukaj. Pra, në pikën 5 pas fjalës “..të emërohet..” të shtohet fjala “më” e cila ka gjithë atë peshë që përmban propozimi i zonjës Vukaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Neni 11 Lirimi nga detyra i anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së. Në raport me nenin 10 janë dy momente të ndryshme. I pari ishte shkarkimi për disa arsye ligjore, i dyti është lirimi.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Neni 12 Dorëzimi i Detyrës.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator?

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 12!

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARIT TË KZAZ

Neni 13

Të drejtat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së. Veçanërisht në rastin e sekretarit është transfuzuar neni përkatës i Kodit Zgjedhor ku parashikohen detyrat e sekretarit të KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 13.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 14 Detyrat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Po zoti Çakaj.

Z.M.Çakaj: Po e nderuar, neni 14, pika 2, në detyrat që kryen sekretari i KZAZ-së, nisur nga funksionet që parashikon Kodi Zgjedhor për sekretarin e KZAZ-së, pas pikës "i" propozoj që të shtohet dhe një detyrë tjetër që është në fokusin e detyrave të sekretarit të KZAZ-së dhe konkretisht lidhet me pikën 1, më lejoni ta lexoj nga pika "i" dhe më pas të bëj propozimin konkret. Pika "i" parashikon se "sekretari i KZAZ-së administron dokumentacionin zyrtar për ndërhyrjet e policisë në rivendosjen e rendit publik, kur jashtë qendrës së votimit rrezikohet rendi ose

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

pengohet procesi i rregullt i votimit”. Pas kësaj pike propozoj të shtohet pika “j” Sekretari i KZAZ-së, dokumenton çdo ndërhyrje në rastet e parashikuara në nenin 109 të Kodit Zgjedhor”. Pikat e tjera të vijojnë me germat vijuese. Në detyrat e sekretarit të KZAZ-së të shtohet dhe “dokumenton çdo ndërhyrje në rastet e parashikuara në nenin 109 të Kodit Zgjedhor”.


Znj.I.Nano: Në fakt, ajo ç’ka po shohim në detyrat e sekretarit të KZAZ-së, sikundër thashë më herët janë transfuzuar detyrat e parashikuara në nenin 34 të Kodit Zgjedhor ku është shtuar dhe pika “i” që ju sapo përmendët është pika “h” tek ky nen dhe është shtuar së fundmi. Ndërkohë referuar nenit 109, sigurisht dhe këto janë shtesa të reja që lidhen me dokumentimin e ndërhyrjeve të policisë...

Z.M.Çakaj: Kryesisht kjo ka të bëjë me rolin e ri që i është dhënë Policisë së Shtetit në menaxhimin e situatave të zgjedhjeve, apo votimit. Aktualisht Policisë së Shtetit me ndërhyrjet e reja në Kodin Zgjedhor i është dhënë një rol proaktiv. Gjithësesi në detyrat dhe rolin e sekretarit të KZAZ-së duhet të shtohet dhe dokumentimi i çdo ndërhyrje, krahas detyrave të tjera të ngarkuara nga Kodi Zgjedhor.

Znj.I.Nano: Pra në referencë të nenit 101, pika 7 që është shtuar në kod në korrik 2020 ku bëhet fjalë për dokumentimin e ndërhyrjeve të Policisë së Shtetit në detaje nga administrata zgjedhore, ju mendoni që në KZAZ këtë t’ia atriubojmë sekretarit të KZAZ-së.

Z.M.Çakaj: Po!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Znj.I.Nano: Kolegët, kanë ndonjë diskutim tjetër? Atëherë votojmë propozimin e zotit Çakaj. Pas pikës “i” të shtohet pika “j” dhe të tjerat të marrin renditjen që vijon. Sekretari i KZAZ-së dokumenton çdo ndërhyrje të Policisë së Shtetit sipas rasteve të parashikuara në nenin 109 të Kodit Zgjedhor”. Votojmë këtë propozim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Neni 15 Detyrat e KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Nëse nuk kemi propozim konkret e hedhim në votim nenin 15 sipas variantit të paraqitur.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Neni 16 Selia e KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 16.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)


Kundër: S’ka

Miratohet!

Neni 17 Dokumenti i identifikimit.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 17.

**Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 18 Vula e KZAZ-së dhe përdorimi.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 18 me përmbajtjen si na ka ardhur nga administrata.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 19 Koha e punës e KZAZ-së. Sigurisht koha e punës ndahet në periodha në tre ditë para ditës së zgjedhjeve dhe për ditën e zgjedhjeve pastaj sigurisht për ditën e zgjedhjeve nuk ka orar dhe për ditët deri në nxjerrjen e rezultateve.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë pyetje, propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 19.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

KREU V

MBLEDHJET E KZAZ

Neni 20 Mbledhja e parë e KZAZ-së.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 20.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 21 Mbledhjet e KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë koment, sugjerim, propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 21.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 22 Zhvillimi i mbledhjes së KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë pyetje, koment, propozim konkret për këtë nen? Po!

Përfaqësuesi i PDIU-së: Thjesht një sqarim kisha për pikën 4 se nuk po e kuptoj. “Në mbledhjen e KZAZ-së, anëtarëve, sekretarit dhe pjesëmarrësve u ndalohet çdo lloj komunikimi me telefon ose forma të tjera komunikimi me të tretët”. Çfarë kuptojmë me këtë, nuk duhet të mbajmë telefon fare në tavolinën e mbledhjeve?

Znj.I.Nano: Unë e lexoj “ndalohet çdo lloj komunikimi me telefon ose forma të tjera komunikimi me të tretët”.

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Përfaqësuesi i PDIU-së: Të tretët jemi ne. Nuk e kuptoj, në qoftë se është e mundur të kemi një sqarim.

Znj.I.Nano: Po Komisioneri!

Z.I.Celibashi: Këtu flitet gjatë zhvillimit të mbledhjes, ashtu sikurse dhe ju, që gjatë zhvillimit të mbledhjes ndalohet komunikimi me telefon. Gjatë veprimtarisë së punës në KZAZ sigurisht që do të mbani telefon. Bëhet fjalë vetëm gjatë zhvillimit të mbledhjes. Në qoftë se doni ta shkruajmë më qartë e shohim, por për këtë moment bëhet fjalë.

Znj.I.Nano: Në qoftë se keni propozim konkret, ju lutem jeni të mirëpritur ta bëni propozimin.


Përfaqësuesi i PDIU-së: Sikur ta qartësojmë “përsa i përket mbledhjeve të KZAZ-së në momentin e diskutimeve nga ana e kryetarit dhe sekretarit... “mund ta lemë “...ndalohet komunikimi me telefon”.

Znj.I.Nano: Kur themi në mbledhje, mbledhja fillon dhe mbaron në dy momente të caktuara kohore. Brenda këtij segmenti kohor, nga fillimi dhe mbarimi i mbledhjes, këtë presupozon. Në se ju nuk po e formalizoni dot, ta bëjmë ne?

Përfaqësuesi i PDIU-së: Ta heqim fare them unë!

Znj.I.Nano: Ne ia kemi hequr dhe vetes këtë (mbajtjen e celularit gjatë mbledhjes). Po zoti Çakaj!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Z.M.Çakaj: Aktualisht jemi duke diskutuar nenin 22. Në KREU V kemi hyrë në momentin kohor dhe procedural të mbledhjes së KZAZ-së dhe në vijim neni 20 mbledhja e parë KZAZ-së, neni 21 mbledhjet e KZAZ-së dhe neni 22 zhvillimi i mbledhjes së KZAZ-së, besoj është evidente dhe e qartë që jemi gjatë momentit të mbledhjes, kështu që.. edhe sqarimi i bërë nga Komisioneri mu duk shterrues kështu që mendoj ta lemë kështu siç është.

Znj.I.Nano: Unë kam një propozim atëherë nuk e di në se.. “gjatë mbledhjes së KZAZ-së, anëtarëve, sekretarit dhe pjesëmarrësve u ndalohet çdo lloj komunikimi me telefon ose forma të tjera komunikimi me të tretët.

Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 22 me këtë ndryshim, pra “gjatë mbledhjes..”

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet!

KREU VI

VENDIMET E KZAZ-SË

Neni 23 Mbyllja e diskutimeve dhe votimi i propozimeve.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 23.


Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Neni 24 Vendimmarrja.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 24.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 24!

Neni 25 E drejta e ankimit.

Mendoj se duhet të jenë të interesuar përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret, ose nëse shihni që ju çënohet ndonjë e drejtë në këtë nen? Jo? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 25.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 26 Konflikti i interesit.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 26.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 26!

KREU VII

DOKUMENTACIONI I KZAZ-së

Neni 27 Dokumentacioni i punës së KZAZ-së.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 27.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

KREU VIII PËRGJEGJËSI DHE SANKSIONE

Neni 28 Përgjegjësia e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 28.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 29 Sanksionet administrative. Janë parashikime të kodit.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 29.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka


Miratohet!

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

Neni 30 Sikurse në të gjitha rregulloret që ne kemi miratuar për organizimin dhe funksionimin e disa organeve, duke nisur nga Rregullatori, nga KAS-i, aktualisht duke diskutuar rregulloren për KZAZ-të, kemi parashikuar zhvillimin e

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

mbledhjeve nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Në funksion të situatave në rastin konkret të situatës së pandemive, por dhe çdo lloj situatë tjetër që mund të ndodhë.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë koment për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 30 me këtë përmbajtje.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 31 Ajo që diskutoi pak më herët zoti Çakaj, por e kemi diskutuar dhe më parë, sepse ky është parashikim i Kodit Zgjedhor, “Formimi kalimtar i KZAZ-ve”, ku lidhet me të drejtën e propozimit të anëtarëve të diktuar nga rezultati i zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimi shumicë-pakicë e Kuvendit në momentin e çeljes së tij.

Përfaqësuesit e partive politike parlamentare, kanë ndonjë koment, propozim konkret për këtë nen? Kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator? Votojmë nenin 31.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 32 Shfuqizime. Nëpërmjet këtij akti shfuqizohet një udhëzim i më hershëm i KQZ-së i vitit 2009.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, zgj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

Miratohet!

Neni 33 Hyrja në fuqi. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Zonja Vukaj!


Znj.H.Vukaj: Para se të kalojmë në fund të procesit, kam një minisugjerim, ose propozim, por dhe për fleksibilitet edhe përshtatje me çfarë operojmë sot. Në nenin 6 pika 5, germa “a” kemi certifikatë personale. Pra “Për çdo kandidaturë të propozuar, bashkëlidhur listës paraqitet dokumentacioni: a) Certifikatë personale; Unë sugjeroj që fleksibiliteti do të ishte më i lartë në momentin kur ne në kllapa themi (edhe ato certifikata që shkarkohen sot nga portalet e dedikuara shtetërore) dhe i japim mundësi më shumë gjatë operimit për emërimin e sekretarëve, anëtarëve, apo procesit në tërësi.

Znj.I.Nano: Unë jam dakord ta lehtësojmë procesin, por them që kjo e përfshin, mund ta shkarkojnë dhe marrin certifikatën nga e-albania.

Znj.H.Vukaj: Po, por akti nuk do jetë në zbatim vetëm nga ne, por do të jetë dhe për zbatim edhe në rrethana të tjera dhe ndoshtamund të nxjerrin artificën që duhet një certifikatë me vulë nxjerrë nga gjendja civile siç jemi mësuar në linjën klasike. Për derisa ky lloj modusi ekziston, unë sugjeroj që të shtohet e shprehur tek kjo pikë.

Znj.I.Nano: Certifikatë personale e lëshuar nga zyrat e gjendjes civile, ose e printuara nga portali shtetëror e-Albania. Jemi dakord me këtë propozim kolegë? Atëherë, zonja që po mban shënimet. Në nenin 6, pika 5, germa “a” Certifikatë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.20.11.2020*

personale e lëshuar nga zyrat e gjendjes civile, ose nga portali e-Albania dhe i përfshijmë të dy momentet.

Votojmë nenin 33 me këtë ndryshim

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Kemi miratuar në parim më së pari projektregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”. Kemi votuar nen për nen të gjitha ndryshimet e propozuara dhe të dakordësuara secilin propozim me 5 vota pro. Është momenti të mbyllim diskutimet dhe të votojmë në tërësi aktin.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet me pesë vota pro Rregulloria “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”. Sikurse theksova dhe në fillim të mbledhjes, sot kishim vetëm një pikë në rendin e ditës, miratimin e projektregullores, duke qenë se nuk kemi gjë tjetër mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit për praninë, ju uroj një ditë të mbarë!

Vendimi nr.5

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***